



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

SHKOLLA TEKNIKE ELEKTRIKE “GJERGJ CANCO”

Njoftim për shpalljen e vendeve të lira të personelit mësimdhënës të kulturës profesionale në shkollën Teknike Elektrike

“Gjergj Canco”Tiranë

Në mbështetje të Ligjit nr.15/2017”Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,Udhëzimit nr.11,datë 03.03.2020”Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesëve publikë të arsimit dhe formimit profesional”si dhe Udhëzimin nr.28,datë 14.10.2019.”Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit profesional,Shkolla Teknike Elektrike”Gjergj Canco”Tiranë, shpall vende të lira të punës si më poshtë:

- 1 mësues i lëndëve teorike profesionale në drejtimin TIK
- 1 mësues i lëndës Baza të sipërmarrjes
- 2 mësues të praktikës profesionale të drejtimit Elektroteknikë
- 2 mësues të praktikës profesionale të drejtimit Elektronikë

Kandidati aplikues duhet të përmbushë kriteret si më poshtë:

1. Kriteret të përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

2. Kriteret të posaçme për personelin mësimdhënës të teorisë profesionale

- a) të ketë diplomë të arsimit të lartët të nivelit master i profesionit ose master i shkencave ose të barasvlershme, për profilin e kërkuar,
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet eksperiencë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit

3. Kritere të posaçme për personelin mësimdhënës të formimit praktik

a) të ketë diplomë të shkollës së mesme profesionale ose të nivelit *bachelor* të

Profilit të kërkuar,

b) të ketë paktën 5 (pesë) vjet eksperiencë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;

c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

Dokumentet e aplikimit

a) letër motivimi për pozicionin;

b) jetëshkrimin (CV-në), i cili plotësohet sipas formatit *Europass* në shtojcën 1, të udhëzimit nr.11,datë 3.3.2020

c) të dhënat e aplikuesit, të plotësuara sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 2, të udhëzimit nr.11,datë 3.3.2020

d) fotokopje të kartës së identitetit, fotokopje të diplomës dhe fotokopje të librezës së punës;

e) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;

f) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;

g) vërtetim të gjendjes shëndetësore;

h) vërtetim të gjendjes gjyqësore;

i) vërtetim nga punëdhënësit e mëparshëm, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;

j) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në sekretarinë e shkollës brenda datës 28.08.2020

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve do të bëhet sipas Udhëzimit nr. 11, dt.3.3.2020

Konkurimi do të zhvillohet pranë Shkollës Teknike Elektrike”Gjergj Canco”Tiranë, më datë 31.08.2020

Kopje të udhëzimit nr.11 datë 3.3.2020, do ta gjeni pranë Degës së Financës dhe Administrimit të shkollës si dhe në www.gjergjcanco.edu.al